

Lulëzim Tafa ka lindur më 1970 në Lipjan. Studimet themelore dhe ato të magjistraturës i ka përfunduar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës. Është Profesor Universitar i cili ka punuar në Universitete brenda dhe jashtë Kosovës. Nga viti 2012 deri në vitin 2020 ka qenë Rektor i Kolegjit AAB.

### **Librat e botuara:**

- Gjaku nuk bëhet ujë – përmbledhje me poezi, Rilindja, Prishtinë 1993
- Metaforë e pikëlluar – përmbledhje me poezi, Rilindja, Prishtinë 1995
- Planeti Babiloni – Poezi e dramatizuar, Rilindja, Prishtinë 1997
- Vdekja çon fjalë – përmbledhje me poezi, Prishtinë, 1998
- I kam edhe dy fjalë, përmbledhje me poezi, Faik Konica, Prishtinë 2012
- Shtini n'dhe këto fjalë – përmbledhje me poezi, Faik Konica, Prishtinë 2015
- Flirt, përmbledhje me poezi, Botimet AAB, Prishtinë 2019

Poezitë e tij janë të përkthyer në disa gjuhë të botës dhe të përfshira në disa antologji. Është fitues i shumë çmimeve prestigjioze ndërkombëtare për letërsi. Librat e tij deri më tani janë përkthyer në gjuhët angleze, gjermane, italiane, serbe, kroate, frënge, boshnjake, malazeze, turke, greke, rumune, rome, suedeze, arabe, maqedonase, ruse, hungareze, sllovene, ukrainase etj.

Lulëzim Tafa është anëtar i rregullt i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, anëtar i rregullt i Akademisë së arteve dhe letërsisë në Francë, si dhe mban shumë tituj nderi në Akademi dhe Universitete botërore. Jeton në Prishtinë.